



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:287604
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05634997

CAP.nr.832/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit R.B sh.a, me qendër të selisë Prishtinë, rr.”...”nr...., kundër debitorit M.D dhe A.D nga Klina, rr.”...””, me objekt përmbarimi përmbushja e borxhit, me vlerë 7.547,81 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësueses së përkohshme A.D, e ushtruar kundër aktvendimi të Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Klinë, CPP.nr.81/21, i datës 24.05.2023, me datë 29.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË e pa lejueshme ankesa e përfaqësueses së përkohshëm A.D nga Klina, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Klinë, CPP.nr.81/21, i datës 24.05.2023

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin CPP.nr.81/21, i datës 24.05.2023 ka vendosur si në vijim:

“CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm i debitorit të parë M.D, tashmë i ndjerë, nga Klina, rr.”...””, në procedurën përmbarimore CPP nr.81/21. Për përfaqësues të përkohshëm caktohet A.D, njëherit bashkëshortja e debitorit të ndjerë M.D, me adresë në Klinë rr. “...””, e cila i ka të

gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor, të cilat do t'i ushtrojë deri në përfundim të kësaj procedure përmbarimore.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesja e përkohshme, A.D për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, Aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pa lejuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori R.B Kosovë ka paraqitur propozim për përmbarim pranë Organit Përmbarues me të cilën ka kërkuar që të caktohet përmbarimit ashtu që kreditorët të paguajnë shumën prej 7,547.81 euro, sipas marrëveshjes për kredinë dhe kontratës së pengut.

Organi Përmbarues me urdhrin, P.nr.338/21, i datës 21.10.2021 e ka lejuar urdhrin për përmbarim.

Debitorët në afatin e paraparë ligjor kanë parashtruar prapësim pranë Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Klinë duke kërkuar që të aprovohet prapësimi ndërsa urdhri i përmbaruesit privat të shfuqizohet.

Me anë të prapësimit debitori Ardion Dani ka theksuar se debitori i parë M.D ka vdekur andaj procedura duhet për përfundohet.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas prapësimit, ka caktuar fillimisht përfaqësuesin e përkohshëm për palën debitore, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të ankimuar ka theksuar se në bazë të Çertifikatës së Vdekjes V 10590370, të datës 04.05.2023 lëshuar nga ZGJC Klinë, konstatohet se M.D, me numër personal 1009886679, me datën 02.12.2020 ka vdekur, andaj gjykata bazuar në këto të dhëna dhe sipas propozimit të kreditorit me parashtrësë të veçantë, në bazë të dispozitës së nenit 35.4 të LPP-së, ka vendosur që ta vazhdojë procedurën përmbarimore duke ia caktuar përfaqësuesin e përkohshëm tani të ndjerit M.D, A.D, bashkëshorte e tij dhe njëkohësisht trashëgimtare e tij. Andaj, nga të gjitha arsyet e cekura, e në bazë të nenit 35 par. të LPP-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar lejueshmërinë e ankesës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Klinë, CPP.nr.81/21, i datës 24.05.2023, e paraqitur nga përfaqësuesi i përkohshëm, gjen se ankesa është e pa lejuar.

Sa i përket aktvendimit të nxjerr nga gjykata e shkallës së parë, CPP.nr.81/21, i datës 24.05.2023, i cili është goditur përmes ankesës së paraqitur nga debitori, Gjykata e Apelit vlerëson se pa marrë parasysh që gjykata e shkallës së parë, me rastin e nxjerrjes së këtij aktvendimi, në këshillën juridike dhënë palëve, ka lejuar apo paraparë ankesën si mjet të goditjes, në këtë rast

ky vendim i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë, qartë rezulton se ka të bëjë me ndërmarrjen e veprimeve të caktuara përmbarimore, për të cilat veprime më asnjë dispozitë ligjore të LPP-së, nuk parashihet se lejohet e drejta në ankesë e veçantë. Parimisht dhe ligjërisht veprimet përmbarimore të cilat gjykata e shkallës së parë i ka ndërmarr me aktvendimin e veçantë CPP.nr.81/21, i datës 24.05.2023, për të cilin gjykata ju është neni 35 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, është dashur që gjykata ti ndërmerr përmes nxjerrjes së Konkluzionit, ndaj të cilit nuk lejohet e drejta në ankesë.

Me nenin 3 paragraf 5 të LPP-së, përcaktohet se: ” *Konkluzioni nxjerrët për zbatimin e disa veprimeve dhe për drejtimin e procedurës* ”

Ndërsa me nenin 3 paragrafi 6 i [Ligjit nr. 05/l-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbarimore](#) përcaktohet: “*Kundër konkluzionit nga paragrafi 5. i nenit 3 të ligjit nuk është i lejuar mjeti juridik.*”

Neni 35 paragrafi 7 i LPP-së përcakton se: “*7. Për marrjen përsipër të procedurës dhe shkarkimin e përfaqësuesit të përkohshëm, organi përmbarues vendosë me vendim të dhënë në formë të konkluzionit.*”

Në këtë kuptim, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se ankesa e debitorit, e paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Klinë, CPP.nr.81/21, i datës 24.05.2023, duhet të hedhet poshtë si e palejueshme, me çka edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke u mbështetur në nenin 208 dhe 209 pika a) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.832/2023, të datës 29.04.2024

Gjyqtarja,
Hidajete Gashi Alaj, d.v